


Çfarë të bëni nëse pikët tuaja të EBT-së janë vjedhur në rrugë elektronike



Pikët tuaja të SNAP-it dhe ndihmës ekonomike mund të vidhen në rrugë elektronike edhe nëse ju nuk e humbni asnjëherë kartën tuaj të EBT-së. Kjo ndodh zakonisht nëpërmjet dy llojeve të vjedhjeve, të quajtura “kopjimi i informacionit” (“skimming”) dhe “mashtrimi elektronik” (“phishing”).

Kopjimi i informacionit: Grabitësit vendosin një pajisje në makinerinë e leximit të kartave që përdoren në dyqane, për të kopjuar informacionin e kartës EBT, kartës së kreditit dhe debitit. Hajdutët e përdorin informacionin për të prodhuar karta të rreme (të quajtura “klone”) dhe i përdorin ato për të vjedhur para nga llogaritë. Kopjimi i informacionit mund të ndodhë kudo që ju kaloni kartën tuaj të EBT-së.

Mashtrimi elektronik: është një lloj tjetër skeme ku grabitësit i mashtrojnë njerëzit që të klikojnë në një link (zakonisht të dërguar me anë të mesazhit ose emailit) që i lejon ata të aksesojnë informacionin e llogarisë suaj.

Çfarë duhet të bëj nëse më kanë vjedhur pikët

HAPI 1: Raportojeni kartën tuaj si të humbur (edhe nëse vetë karta nuk është vjedhur). Për të raportuar vjedhjen e kartës suaj, për të kërkuar një kartë të re dhe për të ndryshuar kodin PIN, vizitoni adresën www.ebtedge.com ose telefononi Shërbimin e Klientit të EBT-së në numrin 888-328-6399. Ju nuk do të merrni asnjë pikë zëvendësues nëse nuk e keni raportuar kartën tuaj të EBT-së si të vjedhur. Nëse e keni raportuar kartën si të vjedhur në kohën e vjedhjes, nuk keni nevojë ta raportoni përsëri.


HAPI 2: Merrni historikun e transaksioneve të EBT-së.

Për të paraqitur një kërkesë për pikë zëvendësuese, ju duhet të raportoni datën, vendndodhjen dhe shumën e secilit transaksion individual të paautorizuar (transaksionet e bëra nga ata që e kanë vjedhur kartën tuaj dhe jo nga ju apo pjesëtarët e familjes suaj).

Si të merrni historikun e transaksioneve të EBT-së:




Get



Opsioni 1: Duke kontrolluar historikun e EBT-së në adresën www.ebtedge.com ose duke shkarkuar aplikacionin celular ebtEDGE (mund të shkarkohet në Apple App Store dhe Google Play Store).

Opsioni 2: Duke telefonuar linjën pa pagesë të shërbimit të klientit të EBT-së në numrin 1-888-328-6399. Ju mund të dëgjoni 10 transaksionet tuaja të fundit në menynë e automatizuar, të kërkonit një deklaratë të printuar dymujore të historikut të llogarisë suaj nga menyuja e automatizuar ose një përfaqësues të shërbimit të klientit, apo të rishikoni transaksionet tuaja drejtpërdrejtë me një përfaqësues të shërbimit të klientit. Për transaksionet më të hershme se 15 muaj më parë, do t'ju duhet të flisni me një përfaqësues.

HAPI 3: Paraqisni një kërkesë për pikë zëvendësuese. Pasi të keni identifikuar transaksionet e paautorizuara, jeni gati për të dërguar një kërkesë.



Ka disa mënyra për të dërguar një kërkesë:

1. **Online** në adresën nyc.gov/hra është mënyra më e shpejtë dhe më e lehtë për të paraqitur një kërkesë! Ne ju rekomandojmë që të dërgoni një kërkesë online nëse është e mundur.
2. **Me postë:** Për të marrë një formular të kërkesës:
 - Vizitoni adresën nyc.gov/hra dhe printojeni atë
 - Telefononi numrin e informimit (718-557-1399) dhe kërkoni që t'ju dërgohet një formular me postë.
 - Vizitoni qendrën tuaj lokale

Formularin e plotësuar të kërkesës dërgojeni me postë në adresën:

Department of Social Services
P.O. Box 02-9121
Brooklyn GPO, Brooklyn, NY 11202

Dërgimi i formularit të kërkesës, veçanërisht të kërkesës për dërgimin e formularit me postë, është metoda më e ngadaltë dhe mund të duhet më shumë kohë që të merret kërkesa juaj dhe të jepen përfitimet zëvendësuese.

3. **Personalisht:** Ju mund të vizitoni Qendrën e Aksesit të Pikëve (BAC), Qendrën SNAP, ose Qendrën HASA. Ju mund t'i gjeni qendrat e SNAP-it dhe BAC-së në adresën nyc.gov/hra (nën skedën "Locations" [Vendndodhjet]).

Kur paraqisni një kërkesë

Përveç datës, vendndodhjes, çdo transaksioni të paautorizuar dhe shumës së vjedhur, do t'ju duhet gjithashtu **adresa postare, numri i identifikimit të klientit (CIN) dhe numri i çështjes nga periudha kohore kur janë ofruar pikët tuaja të vjedhura.**

Numri juaj CIN është i shënuar në kartën tuaj të përhershme të EBT-së dhe numri i çështjes suaj është i disponueshëm në çdo njoftim të HRA-së ose llogarisë suaj ACCESS HRA (nëse e keni një të tillë). Nëse ende nuk arrini ta gjeni numrin e çështjes, telefononi numrin e informimit të HRA-së (718-557-1399) ose vizitoni qendrën lokale SNAP, BAC ose HASA.

Nëse ju kanë vjedhur pikët e SNAP-it dhe ndihmës ekonomike, ju duhet t'i raportoni ato në të njëjtin formular kërkesë. Do të ketë seksione të veçanta në formular, kështu që transaksionet nuk do të ngatërrohen.



Në formularin e kërkesës, do t'ju duhet të vendosni datat kur janë vjedhur pikët tuaja të SNAP-it dhe/ose të ndihmës ekonomike dhe datën kur kuptuat se ato ishin vjedhur, transaksionet e paautorizuara, si dhe shumën totale të vjedhur. Sigurohuni t'i mbani të ndara pikët e SNAP-it dhe ndihmës ekonomike dhe të mos i kombinoni të dyja në formular.

Sigurohuni që të shënoni kutinë që vërteton se informacioni që keni dhënë është i vërtetë dhe i saktë. Nëse nuk e plotësoni vërtetimin, formulari i kërkesës nuk do të pranohet.



@NYCHRA



NYCHRA



NYCHRA